



JERUSALEMI:  
KRYESOR<sup>NË</sup>  
SYTË<sup>E</sup> Tij.

*The*  
**Berean**  
**Call**

QERSHOR 2006

*KOZMOSI DHE KRIJUESI*

*nga DAVE HUNT*

# THIRRJA E BEREASVE

“[Bereasit] . . . i shqyrtuan çdo ditë Shkrimet, [për të parë] nëse këto gjëra ishin ashtu”. —VEPRAT 17:11

WWW.THEBEREANCALL.ORG

— VËLL. XXI NR. 6 —

QERSHOR 2006

## Kozmosi dhe Krijuesi

Dave Hunt

Presidenti Bush ka thënë: “Ne jemi krenarë për programin tonë të hapësirës .... Ne i kemi marrë përsipër udhëtimet hapësinore sepse dëshira për të eksploruar dhe për të kuptuar është pjesë e karakterit tonë .... Duke përdorur Mjetin e Eksplorimeve me Ekuipazh [që nuk është ndërtuar ende], ne do të ndërmarrim misione të zgjatura me njerëz në hënë ... duke jetuar dhe punuar atje për periudha sa vjen e më të gjata .... [Ne], atëherë do të jemi gati të ndërmarrim ... misione me njerëz për në Mars dhe në botët e gjithësisë ... ne do të zhvillojmë një mënyrë të re prodhimi për forcën e shtytjes, për mbështjetjen e jetës si dhe për sistemet e tjera që të mund të ndihmojnë udhëtime më të largëta ... qeniet njerëzore po i drejtohen kozmosit!”

Ky ishte një fjalim që u prit me entuziazëm nga Agjencia Hapësinore NASA. Por një reflektim i shkurtër dhe i sinqertë zbulon këtë të vërtetë të thjeshtë: distancat e pafund të kozmosit paraqesin një pengesë të pakalueshme për ambiciet tona të mëdha. Sonda hapësinore Udhëtari I udhëton rreth 536 milionë km për vit. Nëse do të arrijë të mbijetojë, asaj do t'i duhen rreth 162.000 vjet për të arritur Alfa Centaurin, sistemin më të afërt yjor të galaktikës sonë ku mendohet të ketë disa planetë. Anijes kozmike do t'i duhet rreth 1.3 miliardë vjet për të arritur galaktikën më të afërt jashtë yjësive së Rrugës së Qumështit, Galaktikës Eliptike të Shigjetarit dhe më tepër se tre miliardë vjet për të arritur galaktikën tjetër më të afërt, Galaktikën e Errët e të Madhe të Magellanit.

Si mund të jenë këto ëndrra kaq të largëta për dobinë e kujtdo që jeton sot? A s'duhet që të pranojmë faktin përluleshës që mjetet e “sondave hapësinore” janë të paralizueshme jashtë sistemit tonë diellor? “Po i drejtohem kozmosit?” Fjalë të guximshme, por tërësisht qesharake!

Ja, ne jemi duke dërguar mesazhe radioje në hapësirë dhe ato udhëtojnë me shpejtësinë e dritës, 298.000 km për sekondë. Kjo është shpejt, por jo aq shpejt sa “për t'iu drejtuar kozmosit”. Me këtë shpejtësi, do të duhet 100.000 - 150.000 vjet për të kaluar galaktikën tonë, Rrugën e Qumështit si dhe mijëra e miliardë vite për të arritur galaktikat e tjera, që mund të ketë me miliardë. Përse të vazhdojmë duke mashtruar veten?

Radioja e arrin Alfa Centaurin për 4.3 vjet, kështu që teorikisht ne mund të marrim një përgjigje në më pak se 9 vjet. Ne kemi qenë duke dëgjuar për tinguj inteligjentë radioje që prej vitit 1960 dhe deri tani s'kemi patur ndonjë sinjal. Janë edhe vetëm tre sisteme të tjera yjore

me mundësinë e një përgjigjeje me radio në më pak se 100 vjet dhe më pas distancat rriten shpejt: 130 vjet për Aldebaranin (ylin më të shndritshëm në Taurus), 150 vjet për Regulus (ylin më të shndritshëm në Leo), mbi 500 vjet për Spica (ylin më të shndritshëm në Virgo), afro 800 vjet për Plejadat, 3.000 për Orionin, 12.000 për Mjegullnajën e Gaforres etj. Shumë prej yjeve të Rrugës së Qumështit janë shumë mijëra vite larg për t'iu kontaktuar me radio. Në vitin 1974 një mesazh radioje iu drejtua një grumbulli të stërmadh yjesh që njihet si M13, por mesazhit do t'i duhen 25.000 vjet për të shkuar atje dhe 25.000 të tjera për të marrë një përgjigje.

A përfaqësojnë projekte të tilla një harxhim të mirë të kohës, përpjekjeve dhe parave? Duke kundërshtuar pranimin e Krijuesit, i cili ofron mundësi të menjëhershme hyrjeje tek Ai, shkencën vazhdon përpjekjet për të eksploruar universin jashtëzakonisht të madh që ajo s'pranon se Ai e ka krijuar. Teleskopët tanë më të fuqishëm as nuk mund të na e tregojnë gjithësinë siç duket sot por si dukej kohë më parë kur drita e pasqyruar filloi udhëtimin e saj drejt nesh. Çfarë krenari e verbër e xhit këtë çmenduri?!

Disa astronomë argumentojnë se graviteti duket se vepron menjëherë gjatë gjithë universit; dhe prandaj, nëse ne mund të sigurojmë sisteme shtytjeje përmes gravitetit, ne mund të udhëtojmë pothuaj kudo në gjithësi brenda një kohe shumë të shkurtër. Por shumë shkencëtarë të hapësirës (dhe nga NASA) pranojnë që shpejtësia e dritës, që është vërtetuar se është maksimumi për grimcat në lëvizje, nuk mund të tejkalohet nëpërmjet objekteve fizikë.

Një pjesë e madhe e fantashkencës (madje edhe nga të krishterë të vetëquajtur si C. S. Lewis) ka përhapur idenë që qenie inteligjente të ngjashme me njeriun populojnë planetë të tjerë në gjithësi. Billy Graham, i cili e pranon evolucionin si një mënyrë që Perëndia mund të ketë krijuar njeriun, ka thënë: “Unë besoj se ka jetë në planetë të tjerë ... nuk mund ta përfytyroj që ne të jemi i vetmi [planet] që ka jetë. Kjo do të ishte një ... gjë egoiste për ne të thonim”. Sa për të predikuarit e ungjillit në planetë të tjerë, Billy ka thënë: “Do të doja, por askush nuk më ka ftuar ... nuk besoj se do të mund të flas gjuhën e tyre ...”. Çfarë *ungjilli* mund të jetë ai?

Miliarda dollarë po shpenzohen për të kontaktuar jetë inteligjente “diku atje” me shpresën që “ne nuk jemi vetëm”. Anija kozmike Udhëtari mori këtë mesazh nga Presidenti Karter, e datës 16 qershor, 1977: “Nga të 200 miliardë yjet në galaktikën e Rrugës së Qumështit, disa ... mund të kenë planetë të populluar dhe qytetërimi me udhëtime në hapësirë. Nëse një qytetërim i tillë ndalon Udhëtarin ... ja cili është mesazhi ynë: Ne ...

shpresojmë që ndonjë ditë ... t'i bashkohemi një komuniteti [që të përbëhet nga] qytetërimi galaktikash. Kjo [është] vendosmëria tonë ... në një univers të madh dhe madhështor”. Kjo është absurde sipas Biblës, megjithatë komuniteti shkencor dhe akademik – dhe shumë të krishterë – e marrim shumë seriozisht.

Karteri thotë se është i krishterë. Por shpresa që i ofron qenieve njerëzore është për “t'i bashkuar në një komunitet [që përbëhet nga] qytetërimi galaktikash”? Kjo vështirë se është çfarë Jezusi donte të thoshte me shtëpinë e Atit ku “ka shumë banesa” (Gjo. 14:2, 3)! “Shpresa dhe vendosmëria” e Karterit më bëri të titulloj një libër: *Çfarë i ka ndodhur qiellit?*

Evolucionistët arsyetojnë se nëse jeta mund të ndodhë rastësisht mbi tokë, ajo mund të ketë ndodhur në miliona dhe ndoshta miliardë planetë të tjerë – dhe sfida është për t'i gjetur. Por jeta nuk mund të ndodhë kur rastësisht. Ky fakt përkrahet nga prova të shumta shkencore, edhe pse shumë shkencëtarë e mohojnë këtë nga dëshira për t'iu arratisur llogarisë që kanë për t'i dhënë Krijuesit.

Kjo evidencë shkencore kërkon një konkluzion të pashmangshëm: në mënyrë unike vetëm toka është e përshtatshme për jetë dhe universi ka për qëllim për ta mbajtur atë. Gjatë uljes së parë me njerëz në hënë, William Anders shpalli: “Për të gjithë njerëzit në tokë ekuipazhi i Apollo 8 ka një mesazh që dëshiron t'ju përcjellë ... ‘Në fillim Perëndia krijoi qiejt dhe tokën ...’”. Anders, që u pasua nga Jim Lovell dhe Frank Borman, transmetuan në tokë dhjetë vargjet e para të Zanafillës (megjithëse paqëllim Anders e kaloi vargun e tretë).

Pas kthimit të tyre në tokë, një reporter e pyeti Borman nëse e kishte parë atje sipër Perëndinë apo jo. Ai iu përgjigj: “Jo ... por pashë dëshminë e Tij”. Wernher von Braun, shkencëtar gjerman raketash i Luftës së Dytë Botërore, i cili u bë themeluesi i programit hapësinor të Amerikës dhe drejtori i parë i NASA-s, u shpreh kështu: “Dikujt nuk mund t'i vihen në dukje ligji dhe rregulli i gjithësisë pa arritur në konkluzionin që prapa gjithë kësaj duhet të ketë projektim dhe qëllim”. Në një letër drejtuar Bordit Shtetëror për Edukim të Kalifornisë (14/09/1972) von Braun shkruan:

Përvojat me shkencën më çuan te Perëndia. ... Të provoj ekzistencën e Perëndisë? Mos vallë duhet të ndezim një qiri për të parë diellin ...? Sa më mirë që i kuptojmë mekanizmat komplekse të universit ... aq më shumë mrekullohem me planin e pandarë mbi të cili ai bazohet.

Ndërsa pranimi i një projektimi ... përfundimisht ngre pyetjen e një Projektuesi (një temë kjo jashtë shkencës), metoda shkencore nuk na e lejon përshtatimin e atyre të dhënave që na çojnë në konkluzionin që universi, jeta dhe njeriu bazohen mbi

projektimin.

Të detyrohesh të pranosh vetëm një përfundim – që çdo gjë në gjithësi ka ndodhur rastësisht – do të thotë të shkelësh pikërisht objektivitetin e vetë shkencës.

Për shkak ... të ndershmërisë shkencore e aprovoj paraqitjen e teorieve alternative për origjinën e universit, të jetës e njeriut në orën e mësimit të shkencës.

Perëndia e krijoi Adamin dhe Evën për të populluar tokën (Zan. 1:28). Kur ata rebeluan dhe duhej që të dëboheshin nga kopshti, Perëndia nuk rënkoi kështu: “Ata më zhgënjyen. Do e provoj përsëri në një planet tjetër”. Perëndia e dinte që Adami dhe Eva do të mëkatonin – dhe Ai e dinte se si do ta shpengonte njerëzimin. Krishti është quajtur “Qengji, që ishte vlarë që nga krijimi i botës” (Zbu. 13:8). Siç ka thënë von Braun: “Perëndia me qëllim e uli Veten në shtatin e njerëzimit për ta vizituar tokën personalisht, sepse efekti grumbullues i krijuar gjatë shekujve nga mijëra individë që zgjodhën për t’i pëlqyer vetvetes dhe jo Perëndia kishte infektuar tërë planetin”.

Çdo qenie inteligjente dhe moralisht përgjegjëse me fuqinë e zgjedhjes do të mëkatojë pashmangshmërisht. Prandaj do të ishte e pakuptimshme që Perëndia “t’ia fillonte nga fillimi” me Adamë dhe Evë të tjera në një apo edhe mijëra planetë të tjerë. Kjo vetëm sa do e mbushte gjithësinë me më shumë rebelë. Duke qenë se “Perëndia është dashuri”, Atij i duhet të shpengojë mëkatarët duke paguar dënimin e pafund për mëkatin në vend të krijesave të kufizuara, që në rast të kundërt do të vuajnë gjykimin e Tij të drejtë përjetësisht. Në mënyrë që të paguante për mëkatin e tyre në vend të tyre, Krijuesit i duhet të bëjë si një prej tyre. Siç duket ky fakt e kufizon shpengimin (dhe si rrjedhim edhe krijimin) në një racë qeniesh inteligjente dhe moralisht përgjegjës. Shpëtimi mund të jetë vetëm për njeriun, kështu që Perëndia nuk do të krijojë të tjerë.

Krishti u bë njeri që të shpengojë njerëzimin. Ai nuk të mund të kishte lindur edhe si ndonjë krijesë tjetër në planetë të tjerë për t’i shpenguar ata. Perëndia ka vetëm një Bir për të dhënë dhe Ai ia dha Atë kësaj bote (Gjo. 3:16). Ai premtoi se do t’i marrë ata që besojnë në Të në shtëpinë e Atit të Tij ku ka shumë banesa (Gjo. 14:2, 3), duke çuar “shumë bij në lavdi” (Heb. 2:10), “të ngjashëm me shëmbëlltyrën e tij” (Rom. 8:29; 1 Kor. 15:49; 2 Kor. 3:18; Kol. 3:10). Ai mund ta bëjë këtë vetëm për racën njerëzore, anëtar i së cilës Ai është në përjetësi.

Pafundësia e këtij universi dhe numri jashtëzakonisht i madh i galaktikave dhe yjeve e bëjmë akoma më të çuditshëm faktin që ky një planet kaq i vogël është qendra e vëmendjes së Perëndisë. Dhe sa më shumë që mësojmë për gjithësinë, aq më tepër i qartë bëhet fakti i mahnitshëm që Perëndia i krijoi të gjitha këto për tokën dhe banorët e saj! (Shiko *Planeti i privilegjuar* në listën e ofertave).

Më mahnitës nga të gjithë është fakti që vetë Krijuesi u bë një njeri mbi këtë tokë përmes një lindjeje virgjërore për t’ia zbuluar Veten

njerëzimit, duke e ditur plotësisht mirë që ata do ta refuzonin, do ta tallnin dhe do ta kryqëzonin. Von Braun ka thënë: “Kur Perëndia u bë një njeri ... u vu në skenë një situatë pa precedent në historinë e tokës. Perëndia do t’i vizitonte krijesat dhe ato do e gozhdonin Atë në kryq!” Megjithatë, duke iu përgjigjur me dashuri refuzimit dhe urrejtjes së pashpirt të njeriut, Krishti i kërkoi Atit që “t’i falte ata” dhe Ai e dha jetën e Tij personalisht për të paguar dënimin edhe për mëkatin e atyre që e kryqëzuan! Çfarë dashurie! Çfarë mëshirë! Çfarë hiri!

Me vdekjen merr fund jeta fizike, por jo ekzistenca tonë. Nëse do të ishte kështu, neve nuk do të na duhej një Shpëtimtar dhe do të ishte më mirë të ndiqim atë filozofinë që thotë: “Le të hamë e të pimë, sepse nesër do të vdesim”. Por Bibla thotë që pas vdekjes vjen gjykimi (Heb. 9:27). Ja përse ne kemi nevojë për shpëtim – për t’u çliuruar nga ndëshkimi i përjetshëm për mëkatin tonë. Siç ka thënë von Braun: ‘Çdo gjë që shkenca më ka mësuar ... forcon besimin tim në vazhdimësinë e ekzistencës sonë shpirtërore pas vdekjes ...’.

Në mënyrë të përsëritur Bibla deklaron që universi jep prova për një Krijues të pafund për çdo person që mendon dhe që ndërgjegjja e gjithsecilit e njeh ligjet e Perëndisë dhe që këto ne i kemi shkelur në mënyrë të përsëritur (Rom. 1, 2). Edhe gjykimi i shëndoshë na tregon që dënimi për t’hyrjen qoftë edhe një herë të ligjit nuk mund të paguhet duke e zbatuar atë në mënyrë të përsosur në të ardhmen ose nëpërmjet çfarëdo numri veprash të mira. Duke kundërshtuar këtë fakt të qartë, fetë ofrojnë skema të ndryshme (të thuash të drejtën skema mashtrimi) për t’i pëlqyer Perëndisë përmes ritualeve ose veprave të mira. Ata që ngulin këmbë për pandershmëri të tilla fetare shkelin vetë ndërgjegjen e tyre dhe refuzojnë faljen e Zotit që prej natyre e dinë që s’mund ta meritojnë por që vetëm Perëndia mund ta sigurojë. Prandaj edhe ata nuk mund të shfajësohen duke thënë se nuk e kanë dëgjuar kurrë që Krishti pagoi dënimin e plotë për mëkatin e tyre kur Ai vdiq. Ata kanë refuzuar atë që universi dhe ndërgjegjja e thonë sheshit.

Bibla përmban qindra profeci (të cilat i kemi diskutuar me hollësi në të kaluarën) përse i përket ardhjes së Mesias/Shpëtimtarit: prejardhja e Tij është parathënë; vendi i lindjes së Tij; dita e saktë kur Ai do të hynte në Jeruzalem, madje edhe kafsha mbi të cilën do të hynte; refuzimi i Tij nga judenjtë dhe nga bota; kryqëzimi i Tij; ringjallja dhe ngritja e Tij në qiell; ringjallja dhe rrëmbimi i të shpenguarve në qiell, kthimi i tij në tokë për të mbretëruar etj. Këto profeci e kanë identifikuar në mënyrë të padyshimtë Jezusin nga Nazareti si Mesian. Ata që me dashje i mohojnë këto fakte dhe e refuzojnë Atë janë dyfish të dënuar.

Ishte pikërisht mbi planetin Tokë që Krishti u lind si njeri, jetoi e vdiq, dhe po në këtë tokë Ai do të kthehet. Sipas Biblës, kjo tokë është qendra e universit, në kuptimin që të gjitha planet e ardhme të Perëndisë përfshijnë njerëzimin. Njeriu u krijua sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë (Zan. 1:26, 27). Shpengimi është i

tëri për të. Shkrimi thotë: “Në fakt një është Perëndia, dhe një i vetëm është ndërmjetësi midis Perëndisë dhe njerëzve: Krishti Jezus njeri ...” 1 Tim. 2:5).

Krishti ofroi “për gjithnjë një flijim të vetëm për mëkatin” (Heb. 10:12) – vepra e Tij e shpengimit përfundoi përgjithnjë. Ajo ngjarje kozmike, që përcakton tërë historinë, ndodhi në tokë për të shpenguar njerëzimin. Është përmes “gjakut të kryqit” që është bërë paqe, duke i dhënë Perëndisë mundësinë për “të pajtojë për veten të gjitha gjërat, ... mbi dhe [dhe] në qiejt” (Kol. 1:20). Është në Krishtin (për meritë të vdekjes dhe ringjalljes së Tij) që Perëndia do t’i sjellë në një krye të vetëm ... të gjitha gjërat, ato që janë në qiejt dhe ato që janë mbi dhe” (Efe. 1:10). Është përmes vdekjes së Krishtit në kryq që Satani është mposhtur, që vetë qielli është pastruar dhe që një univers i ri do të krijohet pa praninë e mëkatin – dhe atje Perëndia do të banojë me njeriun, mbi tokë, përgjithmonë.

Ishte në tokë që Satani erdhi për të shkatërruar krijimin e Perëndisë dhe po në tokë “dragoi i madh, gjarpi i lashtë, që është quajtur djall, edhe Satan” (Zbu. 12:7-10) do të hidhet nga qielli. Beteja përfundimtare midis Perëndisë dhe Satanit do të luftohet për fatin e tokës dhe armiku i Perëndisë dhe i njeriut do të kufizohet në “liqenin e zjarrit ... dhe do të mundohet ditë e natë në shekuj të shekujve” (Zbu. 20:10-15).

Ajo që është akoma më mahnitëse është fakti që në këtë planet të vogël është një qytet shumë i vogël që është shumë i çmuar për Krijuesin e këtij universi të pafund. Ky qytet është Jeruzalemi, që është përmendur 811 herë në Bibël dhe *as edhe një herë* në Kuran – një fakt që e vë në dukje pretendimin e myslimanëve për Jeruzalemin si një gënjeshtrë të pacipë. Në këtë “qytet të shenjtë” (Neh. 11:1; Isa. 48:2; 52:1; Mat. 4:5 etj.), Krishti u pranua si Mesia nga qindra, dhe ndoshta nga mijëra njerëz, të rreshtuar përgjatë rrugës nga Mali i Ullinjve ndërsa Jezusi hyri ngadhënjimisht përmes portës lindore – një ngjarje kjo që është festuar qysh atëherë si E diela e Palmave. Katër ditë më vonë, e njëjta turmë thirri: “Largoje! Kryqëzoje! Ne nuk duam që ky të mbretërojë përmbi ne” – dhe Ai u gozhdua në kryq në periferi të Jeruzalemit.

Ky është qyteti që Perëndi do të që dëshiron ta bekojë, por që është rebeluar kundër Tij vazhdimisht. Ky është “qyteti i Perëndisë” (Psa. 46:4; 87:3), qyteti në të cilin Perëndia dërgoi profetë ditë pas dite, javë pas javë, vit pas viti, duke iu bërë thirrje për pendim. Ky është Sioni, “qyteti i Davidit” (2 Sam. 5:7; Neh. 12:37; Isa. 22:9 etj.) mbi të cilin Krishti qau, dhe që përfundimisht Perëndia e shkatërroi për shkak të ligësisë së tij, por që ka premtuar se do ta restaurojë plotësisht.

Perëndia vazhdon të mbrojë Jeruzalemin. Ai do t’i ndëshkojë të gjitha kombet sepse kanë mohuar rolin e tij në planin që Jeruzalemi ka për universin. Ky është qyteti që, në përmbushje të profecive të thëna mijëra vite më parë, është bërë një barrë për tërë botën. Pikërisht Jeruzalemi (në dashtë Zoti) do të jetë çështja kryesore e një artikulli më të plotë në korrik.

**P&P** .....

**PYETJE:** Çfarë do të thotë Bibla kur thotë që dishepujt “i lanë të gjitha dhe ndoqën atë”? A është gjithsecili i thirrur për të shërbyer me kohë të plotë? A na lejon Perëndia që të kemi zotërime? Si mundet dikush të mbajë dhe të rritë një familje ndërsa në të njëjtën kohë “të heqë dorë nga të gjitha ato që ka”? Dëshiroj që të ndjek me gjithë zemër Zotin kudo që më drejton, dhe nuk dua të zbrapsem cilido qoftë çmimi, por gjendem në mëdyshe për atë se çfarë do të thotë kjo.

**PËRGJIGJE:** Ne të lavdërojmë për këtë shqetësim të sinqertë me të cilin shumë të krishterë nuk duan të përballen. Nuk duam të mpijmë teshun e Shpatës së Frymës, por as nuk duam të keqpërdorim Fjalën e Perëndisë. William MacDonald citon George Verwer: “Bibla ose do të thotë atë që thotë ose ne duhet ta flakim atë tutje”. Por çfarë do të thotë Bibla me atë që thotë? Kjo mbetet një pyetje e sinqertë jo vetëm për këtë situatë por edhe për vargje të tjera.

Siç duket, “të heqësh dorë” nuk është njëllor me “të braktisësh” ose “të japim”. Po të ishte kështu, atëherë neve do na duhet të braktisim të gjitha rrobat dhe të ecim në rrugë lakuriq, të braktisim gjithë ushqimin dhe të mos kemi asgjë për të ngrënë, të japim çdo mobilie dhe të ngelemi pa shtretër, karrige apo tavolina, t’i japim të gjitha paratë që kemi dhe do të na duhet të mbështetemi mbi dhuratat e të tjerëve që nuk kanë “hequr dorë nga të gjitha” etj. Mirëpo, shumë do të thonë që kjo është ekstremizëm qesharak. Por si përcaktohet “ekstremizmi”? Bibla do të thotë atë që thotë – por çfarë do të thotë?

“Hiq dorë nga të gjitha!” mund të jetë një sfidë dënuese kur bashkohet me shprehjen “Të gjitha do të thotë të gjitha!” Por ai që e thotë këtë ndoshta ka diçka që nuk e ka dhënë ose braktisur: ndoshta një makinë, ose dyshekun ku fle, ose të paktën disa rroba etj. A duhet që karpentieri të japë të gjitha veglat e tij, piktori të gjithë penelët e tij, fermeri plugun e tij – dhe të mos kenë asnjë mjet për të fituar të ardhurat? Nëse jo, atëherë si mund të thonë që kanë hequr dorë nga të gjitha për të ndjekur Krishtin? Nëse dikush jep shtretër e batanije dhe përdor vetëm një thes gjumi, përsëri ai nuk ka braktisur gjithçka. Gjykimi i shëndoshë kërkohet për të kuptuar Biblën.

William MacDonald shkruan: “Urdhërimi për të hequr dorë nga të gjitha përmban vlera të mëdha tronditje. Ky urdhërim na zgjon nga ai lloj krishterimi i vakët, i pudrosur e i sheqerosur që shohim sot. [Por] të hequr dorë nga të gjitha nuk është njëllor për një çift me një familje të madhe siç është për një beqar. Nuk është njëllor për pronarin e një kompanie që kërkon aktiv siç është për një nëpunës. Si beqarët ashtu dhe çiftet

e martuara duhet të ulen në gjunjë dhe të pyesin: ‘Zot, çfarë do të thotë kjo në jetën time ose në jetën tonë?’ Pastaj, ndërsa Zoti fillon të vërë gishtin mbi zotërime materiale, ata duhet të jenë të gatshëm të heqin dorë nga ato dhe t’i vendosin të ardhurat e tyre në veprën e Zotit dhe për bekimin e shpirtave të pavdekshëm”.

Duke e krahasuar Shkrimin me Shkrimin dhe duke e marrë gjithë Biblën në kontekst, ti mund të kuptosh që ne nuk duhet të mbajmë asgjë si tonën, por që gjithçka i përket Zotit për t’u përdorur siç Ai na drejton – dhe jo që të keqpërdoret ose të shpërdorohet: “përdorni nga kjo botë, sikur të mos e shpërdorni” (1 Kor. 7:31). Nuk janë zotërimet e gjërave ose sasia apo cilësia e tyre, por qëndrimi i zemrës. Megjithatë, William MacDonald na kujton që: “Qëndrimi i zemrës është i rëndësishëm, por ... ai duhet të kthehet në veprim”. Siç ka thënë Pali: “Unë di ... të nginjem dhe të kem uri, të kem me tepri dhe të vuaj në ngushticë” (Fil. 4:12).

Si Jezusi ashtu dhe Jakobi i dënuan të pasurit. Por çfarë do të thotë “i pasur”? “Të varfërit” e vendeve perëndimore mund të jenë “të pasur” në shumë vende. Po, Jakobi i dënoi të pasurit, por jo për sasinë e parave apo zotërimeve të tyre. Përkundrazi ishte për faktin që ata po jetonin për veten dhe kënaqësitë të tyre dhe që me mashtrim ua kishin ngrënë pagën punëtorëve (Jak. 5:1-6). Jezusi thotë: “Mjerë ju, o të pasur ...” (Llu. 6:24); dhe Ai shpall: “Është më e lehtë që një deve të kalojë nëpër vrimën e një gjilpëre, sesa të hyjë një i pasur në mbretërinë e Perëndisë” (Mar. 10:25). Përsëri na duhet të bëjmë pyetjen: “Sa para ose sa zotërime e bëjmë dikë të pasur? Sa e mirë duhet të jetë një shtëpi ose një makinë që të jetë tepër e mirë?” Jezusi nuk na ka lënë matje të tilla, por dënoi “ata që mbështeten te pasuria” (v. 24). Jo paraja, por “lakmia për para” është “rrënja e gjithë të këqijave” (1 Tim. 6:10). Kujdes këtu: ne duhet t’i kërkojmë Perëndisë të hetojë zemrat tona.

Jozefi nga Arimatea është përmendur për mirë në çdo ungjill. Ai është quajtur një “dishepull” (Mat. 27:57), një “këshilltar i respektuar” (Mar. 15:43), një “njeri i drejtë dhe i mirë” (Llu. 23:50, 51) dhe përsëri një “dishepull [i fshehtë derisa kërkoi trupin e Jezusit]” (Gjo. 19:38-42). Megjithatë ai ishte “një njeri i pasur” (Mat. 27:57) dhe nuk është kritikuar për të qenë i pasur. Nëse nuk do të kishte qenë i pasur, ai nuk do të kishte patur një varr bosh tepër për t’ia dhënë Krishtit, dhe as nuk do të ishte përmbushur ajo profeci që Krishti, kur të vdiste, do të vihej “me të pasurin” (Isa. 53:9).

Ne jemi urdhëruar të punojmë (2 The. 3:11-14) dhe kjo nënkupton të ardhura. Ne supozohet t’u japim të varfërve, gjë e cila do të ishte e pamundur nëse nuk do të kishim asgjë për të dhënë. Ai që nuk kujdeset për familjen e tij “e ka mohuar besimin e tij dhe është më i keq se një jobesimtar” (1 Tim.

5:8). Pali foli për “të mbledhurit e ndihmave për shenjtorët”, gjë që duhej marrë të parën ditë të çdo jave (1 Kor. 16:1, 2); dhe ai nuk sugjeroi kurrë që ata të mos mbanin asgjë për veten e tyre, por i lavdëron ata për “bujarinë” e tyre (v. 3).

Po, por çfarë bëri kisha e hershme? A nuk i shiti ajo “pronat e pasuritë ... të gjithë që zotëronin ara ose shtëpi i shitmin ... dhe i vinin [të ardhurat] te këmbët e apostujve (Vep. 2:45; 4:34, 35)? Kjo s’mund të thotë që ata i shitën banesat e tyre dhe jetuan në rrugë, ose që i shitën feramat e tyre duke mos patur asnjë mënyrë për të siguruar të ardhurat. Ata duhet të kenë shitur toka ose shtëpi që i kishin tepër e që nuk i nevojiteshin. Një takim lutjesh për lirinë e Pjetrit nga burgu u mbajt “në shtëpinë e Marisë, nënës së Gjonit” (Vep. 12:12). Pali jetoi si i burgosur në Romë “plot dy vjet në shtëpinë që kishte marrë me qira” (Vep. 28:30). Gjoni shkruan sikur çdo familje e krishterë jeton në shtëpinë e vet (2 Gjo. 10). Fakti që të krishterët jetojnë në shtëpitë e tyre (jo medemos të marra me qira), dhe që shpesh kisha mblidhej në shtëpitë e të krishterëve është përmendur shumë herë: Veprat 2:46; 5:42; 8:3; 10:6, 17, 32; 20:20; 21:8; Rom. 16:5; 1 Kor. 1:11 etj.

Jezusi tha: “Mos mblidhni për vete thesare mbi tokë” (Mat. 6:19). Por Pali ka thënë që prindërit duhet “të mbledhin ... për bijtë” (2 Kor. 12:14). A është Pali duke kundërshtuar Jezusin? Jo. Krishti e përkufizon një “thesar” si diçka ku është fiksuar zemra (Mat. 6:21). Dhe Pali thotë: “Kini mend gjërat që janë atje lart, jo ato që janë mbi tokë” (Kol. 3:2); kështu që nuk është vlera ose sasia e zotërimeve që është gabim por kur dikush i fikson dëshirat e tij mbi to, duke mos qenë i gatshëm për t’i dhënë. Sikurse thotë MacDonald: “Qëndrimi duhet të kthehet në veprim”. Dhe ai shton: “Ata njerëz që heqin dorë nga të gjitha nuk duhet kritikues ndaj të tjerëve. Të tjerët që nuk bien dakord nuk duhet të gjykojnë ata të cilët me një besim të thjeshtë heqin dorë nga gjithçka”.

Ju pyesni nëse a janë të gjithë të thirrur në “shërbesë me kohë të plotë”. Po sigurisht që të gjithë jemi, por nuk jemi thirrur të gjithë për të njëjtën shërbesë. Të jesh i krishterë është një thirrje me kohë të plotë. Ne duhet të përfaqësojmë Krishtin si ambasadorë të Tij kudo, në çdo moment. Pra, ne duhet të jetojmë gjithmonë për Të. Krishti jeton në çdo të krishterë; Ai është bërë jeta jonë – dhe kjo s’mund të jetë e vërtetë vetëm me kohë të pjesshme. Përcaktimi dhe të jetuarit e asaj se çfarë do të thotë kjo i takon çdo individ ndërsa studion Fjalën dhe drejtohet nga Zoti, i përlurur dhe në nënshtrim të plotë ndaj vullnetit të Tij.

Është e qartë që jo të gjithë jemi thirrur të bëhemi predikues, shkrimtarë, ungjilltarë shëtitës, misionarë në një vend tjetër etj. Çfarëdo profesioni që të kemi ne duhet të jemi dëshmitarë e Tij ndërkohë që edhe jemi

duke i dhënë punëdhënësit tonë përpjekjet më të mira në punën që na ka dhënë dhe për të cilën ai na paguan. Pali përdori analogjinë e një trupi. Trupi ka shumë gjymtyrë që kanë funksione të ndryshme. Ai pyet: “A janë vallë të gjithë apostuj? Janë të gjithë profetë? Janë të gjithë mësues? A kanë të gjithë dhuntinë e veprave të fuqishme? A kanë të gjithë dhuntitë e shërimeve? A flasin të gjithë gjuhë të ndryshme? A interpretojnë të gjithë?” (1 Kor. 12:29, 30). Përgjigjja e nënkuptuar është qartë: “Jo”. Dështimi për të kuptuar këtë fakt të thjeshtë ka qenë shkaku i shumë gabimeve dhe shpërdorimeve midis pentakostalëve dhe karizmatikëve.

Secili prej nesh ka një shërbesë, por jo të njëjtën shërbesë. Ne të gjithë jemi dëshmitarë për Krishtin dhe ungjillin, për ta lejuar Atë të jetojë jetën e Tij në ne dhe përmes nesh dhe për të dëshmuar hirin, dashurinë dhe shpëtimin e Tij me jetët dhe buzët tona. Kjo s’mund të jetë më pak se një shërbesë “me kohë të plotë”!